

KËRKESË PËR OFERTË

Numri i Referencës: 007/2023 /TOKA

TITULLI: Kërkesë për ofertë për shërbime konsulente 'Evaluimi i Impaktit dhe Mundësive për Strategjinë e TOKAs 2024-2029'

Të nderuar,

Ju lutemi të na jepni një ofertë për **shërbime konsulente 'Evaluimi i Impaktit dhe Mundësive për Strategjinë e TOKAs 2024-2029'**, për t'u realizuar gjatë periudhës **1 gusht-31 tetor 2023**, të përshkruara në tabelën më poshtë, në përputhje me Specifikat e shenuara në faqet 2-3 të këtij dokumenti.

Nr.	Përshkrimi	Çmimi (Euro)	Sasia (Dite)	Total (Euro)
3.1	Takime përgatitore me TOKA		2	
3.2	Fokus Grupet me hisedarë		8	
3.3	Gjetjet dhe Rekomandimet		5	

Kushtet e ofertimit

Ofertat pranonen vetëm nga konsulentë individual.

- Oferta duhet të përmbajë:
 - a) CV-në,
 - b) Portfolio me së paku 2 punime relevante nga ofertuesi,
 - c) Një letër oferte maksimum 2 faqe– ku ofertuesi përmbledhë në pika të shkurta metodologjia dhe plani i veprimit, si dhe njohuritë/pervoja që janë relevante për këtë Kërkesë.
 - d) Çmimin me shumen neto (plotësohet tabela më lart).
- Ofertat duhet të jenë valide së paku 60 ditë pas datës së dorëzimit.

Me anë të plotësimit dhe nënshkrimit të kësaj oferte deklaroj se i pranoj kushtet e mëposhtme dhe se si ofertues nuk bie ndesh në asnjë nga kushtet dhe kriteret e përjashtimit të listuara më poshtë.

Emri dhe Mbiemri	
NUI / Nr. Personal	
Nënshkrimi dhe Vula	
Data	

NUMRI I REFERENCËS: 007/2023

TITULLI: Kërkesë për ofertë - **Evaluimi i Impaktit dhe Mundësive për Strategjinë e TOKAs 2024-2029**

AUTORITETI KONTRAKTUES

ORGANIZATA KOSOVARE PËR TALENT DHE ARSIM - (TOKA) e financuar nga donatorët vendas dhe ndërkombëtarë. TOKA është një organizatë jo-fitimprurës e regjistruar në Kosovë me nr. regjistrimi 5200286-9 me misionin e saj për të përshpejtuar ndryshimet shoqërore në Kosovë duke investuar në rininë e saj. Përmes programeve arsimore joformale, formale dhe programeve të Vullnetarizmit Edukativ, ne i ndihmojmë të rinjtë të bëhen të motivuar për tu bërë agjentë të ndryshimeve pozitive sociale.

TOKA është në kërkim të një eksperti/e i/e cili/a do ta realizojë evaluimin e impaktit programeve të TOKAs gjatë periudhës 2018-23, identifikojë nevoja të pa-adresuara, dhe të ofroj rekomandime për strategjinë e TOKAs 2024-29. Specifikat e detajuara janë shënuar më poshtë.

PROFILI I KANDIDATIT/ES

Kjo kërkesë për ofertë është e hapur për individ. Kandidati/ja ideal/e duhet të ketë njohuri dhe përvojë në:

- Metodat e vlerësimit që masin ndikimin e programeve të edukimit joformal dhe formal për të rinjtë, duke përfshirë ata nga komunitetet e marginalizuara.
- Metodat e vlerësimit që masin ndikimin e programeve të ngritjes së kapaciteteve për vullnetarë të modhës madhore, veçanërisht mësimdhenësit.

SPECIFIKAT

1. Objektivat

- 1.1. Evaluimi i aktiviteteve të TOKAs gjatë periudhës 2018-23, duke matur impaktin si the potencialin për zhvillim dhe qëndrueshmëri.
- 1.2. Identifikimi i nevojave të pa-adresuara, dhe
- 1.3. Rekomandime për strategjinë e TOKAs 2024-29.

2. Pyetjet që duhet përgjigjur në raport janë:

- 2.1. Çka nënkuptojnë me 'fuqizim' hisedarët tanë kyç (shih 3.2)? Cilat janë tiparet e një 18 vjeçari/e të fuqizuar?
- 2.2. Cilat janë faktorët kontribues dhe shkatërrues të fuqizimit të të rinjve?
- 2.3. Si mundet një i ri i marginalizuar të zhvillohet nga gjendja e tij aktuale në një të ri të fuqizuar?
- 2.4. Cilat janë tiparet e rinisë së marginalizuar? Cilat janë interesat e tyre, si u pëlqen ta kalojnë kohën e tyre?
- 2.5. A është grupmosha e intervenimeve të TOKAs adekuate (12-17 vjeç)?
- 2.6. S(a) ka vlerë ofrimi i programeve vetëm për njërin gjini?

3. Aktivitetet

3.1. Takime përgatitore me TOKA

- 3.1.1. Takime me stafin e TOKA-s për t'u informuar mbi strategjinë e TOKA-s, programet e kaluara dhe aktuale dhe informata të tjera kyçe organizative.
- 3.1.2. Dorëzimi i metodologjisë, së bashku me planin e punës së aktivitetit

3.2. Fokus Grupet me hisedarë, të përshkruar më poshtë¹

- 3.2.1. Rinia adoleshente - një mostër e alumnive të TOKAs në dy grupmosha (nën 18 vjeç, dhe mbi 18 vjeç), një nga rinia e synuar që nuk ka marrë pjesë kurrë në programet e TOKAs (në total 3 fokus grupe).
- 3.2.2. Prindër të alumnive të TOKAs nën 18 vjeç, dhe prindër nga rinia e synuar që nuk ka marrë pjesë kurrë në programet e TOKAs (në total 2 fokus grupe).
- 3.2.3. Mësimdhënësit (në total 1 fokus grup).

3.3. Gjetjet dhe rekomandimet

- 3.3.1. Dorëzimi draftit preliminar të Raportit.
- 3.3.2. Dorëzimi i raportit përfundimtar, duke përfshirë rekomandimet.

4. Produktet Kryesore/të Dorëzueshme dhe Korniza Kohore

Ofruesi i shërbimit të kontraktuar do të jetë përgjegjës për dorëzimin e produkteve kryesore të treguara më poshtë brenda afateve kohore të dakorduara.

- 4.1. Përshkrimi përfundimtar i metodologjisë së bashku me planin e punës së aktivitetit me afatin kohor dhe strukturën e raportit (5 ditë pune pas nënshkrimit të kontratës).
- 4.2. Drafti i parë i Raportit (25 shtator 2023).
- 4.3. Drafti përfundimtar i Raportit (31 tetor 2023), me anekset/dokumente të tjera përkatëse.

DATA E MBYLLJES: 14 korrik 2023, ora 14.00.

METODA E DORËZIMIT: Dorëzimi elektronik i ofertave

ADRESA PËR DORËZIMIN E OFERTAVE: procurement@toka-ks.org

INFORMACIONE MË TË HOLLËSISHME: Të gjitha pyetjet sqaruese mund të bëhen përmes postës elektronike procurement@toka-ks.org

1.

¹ Veni re: TOKA e organizon aspektin logjistik (ftesa e pjesëmarrësve, hapësira për takim), kurse ofruesi i shërbimit i mbanë fokus grupet dhe përgatit raportet për to.

KRITERET E VLERËSIMIT

Kriteret e vlerësimit	Pikët	Perqindje
Kualifikimi/Niveli i arsimimit	10	60%
Metodologjia dhe plani i veprimit	45	
Përvoja e mëhershme për shërbime të ngajshme	45	
Çmimi	40	40 %
Total	140	100 %

UDHËZIMET E PËRGJITHSHME TË TENDERIT

Të drejtat e rezervuara:

Të gjitha ofertat bëhen pronë e TOKA dhe TOKA rezervon të drejtën në diskrecionin e saj për:

- TOKA mund ta anulojë këtë Kërkesë për Ofertë në çdo kohë. TOKA rezervon të drejtën të refuzojë ndonjë apo të gjitha ofertat e marra.
- TOKA rezervon të drejtën për heqje dorë ndaj çdo devijimi të ofertuesit sipas specifikacioneve të kërkuara, që sipas mendimit të TOKA-së konsiderohen të mos jenë defekte materiale që kërkojnë refuzim ose diskualifikim; ose kur një heqje dorë e tillë do të nxisë konkurrencë në rritje.
- Zgjatë afatit për dorëzimin e të gjitha përgjigjeve të kësaj thirrje për ofertë pas njoftimit të të gjithë ofertuesve.
- Përfundojë ose modifikojë procesin e thirrjes për ofertë në çdo kohë dhe ri-lëshojë thirrjen për ofertë për këdo që TOKA e gjykon të përshtatshme.
- TOKA rezervon të drejtën për të dhënë një kontratë bazuar në vlerësimin fillestar të ofertave pa diskutim.
- Të shpërblejë vetëm pjesë të aktiviteteve në shpallje ose dhënien e shpërblimeve të shumfishta në bazë të aktiviteteve të shpallura.

Njoftimi për ndryshimet: Ofertuesit do të njoftohen me shkrim për çdo ndryshim në specifikimet e përfshira në këtë Kërkesë.

E drejta e Refuzimit dhe sqarimit: TOKA rezervon të drejtën të hedhë poshtë të gjitha ofertat e marra dhe të kërkojë sqarime për çdo informacion nga çdo Ofertues.

Kërkesa për informacion shtesë nga ofertuesi: Para zgjedhjes përfundimtare, ofertuesve mund t'u kërkohej të japin informacion shtesë që mund të konsiderohet i nevojshëm për të vlerësuar më tej ofertat.

Vlerësimi i Ofertave: Ofertat do të vlerësohen nga një Komision Vlerësues.

Kriteret e vlerësimit janë çmimi më i ulët dhe kualiteti i ofruar duke përmbushur specifikimet e përmendura.

Shënim

- Ju lutem vini re se me dorëzimin e ofertës, ofertuesi kupton se Donatori nuk është palë në këtë kërkesë dhe ofertuesi pajtohet që çdo shkresë në vijim duhet të paraqitet - me shkrim me shpjegime të plota – vetëm tek TOKA.
- TOKA mund të kërkojë sqarime nga ofertuesit e zgjedhur - deri në dy ose tre herë prezantim me gojë ose përgjigje me shkrim - shtjellim më specifik dhe fushëveprim më i detajuar i punës bazuar në një fushë të përgjithshme të punës nën thirrjen origjinale.

- TOKA ka të drejtë të anulojë një thirrje, ose të anulojë një kontratë paraprake përpara nënshkrimit të një urdhri blerjeje për shkak të ndonjë ndryshimi të paparashikuar.

Kriteret e përjashtimit nga procedura

Një operator ekonomik do të përjashtohet nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit dhe grantit nëse:

- është i falimentuar, i nënshtrohet procedurave të falimentimit ose të likuidimit, ku aktivitetet e tij janë të administruar nga një likuidues ose nga një gjykatë, ku ai është në një marrëveshje me kreditorët, ku aktivitetet e tij të biznesit pezullohen ose kur është në ndonjë situatë analoge që del nga procedura të ngjashme të parashikuara në ligjet ose rregulloret kombëtare;
- është vërtetuar me vendim të formës së prerë ose me vendim administrativ të formës së prerë që operatori ekonomik është në kundërshtim me detyrimet e tij lidhur me pagesën e taksave ose sigurimeve shoqërore dhe kontributet në përputhje me ligjin e vendit në të cilin është themeluar, me ato të vendit në të cilin është vendosur autoriteti kontraktues ose ato të vendit të kryerjes së kontratës;
- është vërtetuar me vendim të formës së prerë ose me vendim administrativ të formës së prerë që operatori ekonomik është fajtor për sjellje të keqe profesionale të rëndë duke shkelur ligjet në fuqi ose rregulloret ose standardet etike të profesionit të cilit i përket operatori ekonomik, ose duke u angazhuar në çdo sjellje të gabuar që ka një ndikim në besueshmërinë e tij profesionale kur sjellja e tillë nënkupton një qëllim të gabuar ose neglizhencë të rëndë, duke përfshirë, në veçanti, ndonjë të përmendur poshtë:
- me mashtrim apo me neglizhim paraqesin informacionin e kërkuar për verifikim, mungesa e arsyeve për përjashtim ose përmbushja e kriterëve të përzgjedhjes në kryerjen e një kontrate;
- duke hyrë në marrëveshje me operatorë të tjerë ekonomik me qëllim të shtrembërimit të konkurrencës;
- shkelje e të drejtave të pronësisë intelektuale;
- duke tentuar të ndikojë në procesin e vendimmarrjes së autoritetit kontraktues gjatë procedurës së prokurimit;
- duke u përpjekur për të marrë informacion konfidencial që mund t'i japë atyre avantazhe të padrejta në procedurën e prokurimit;
- është vërtetuar me aktgjykim të formës së prerë se operatori ekonomik është fajtor për cilëndo prej tyre në vazhdim:
- mashtrim, brenda kuptimit të nenit 1 të Konventës për mbrojtjen e Evropës
- Interesat financiare të komuniteteve të hartuara nga Akti i Këshillit i datës 26 korrik 1995/17;
- (ii) korrupsion, siç përcaktohet në nenin 3 të Konventës për luftën kundër korrupsionit duke përfshirë zyrtarët e Komuniteteve Europiane ose zyrtarët e Shteteve Anëtare të Bashkimi Evropian, i hartuar nga Akti i Këshillit i 26 Majit 1997/18, dhe në Nenin 2 (1) të Ligjit të Këshillit Vendimin Kornizë të Këshillit 2003/568 / JHA, si dhe korrupsionin siç përcaktohet në ligjin e vendit ku është vendosur autoriteti kontraktues, vendi në të cilin operatori ekonomik është themeluar ose vendi i ekzekutimit të kontratës;
- pjesëmarrje në një organizatë kriminale, siç përcaktohet në Nenin 2 të Kornizës së Këshillit Vendimi 2008/841/JHA;
- pastrimit të parave ose financimit të terrorizmit, siç përcaktohet në Nenin 1 të Direktivës 2005/60 / EC të Parlamenti Evropian dhe Këshilli 21;
- veprat penale të lidhura me gabime ose veprat penale të lidhura me aktivitetet terroriste, siç përcaktohet në nenet 1 dhe 3 të Vendimit Kornizë të Këshillit 2002/475/JHA, respektivisht, ose nxitjen, ndihmën ose inkurajimin ose përpjekje për të kryer vepra të tilla, siç referohet në nenin 4 të atij vendimi kornizë;

- punës së fëmijëve ose formave të tjera të trafikimit të qenieve njerëzore siç përcaktohet në nenin 2 të Direktivës 2011/36 / BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit; operatori ekonomik ka treguar mangësi të konsiderueshme në përmbushjen e detyrimeve kryesore në kryerjen e një kontrate të financuar nga BE, e cila ka çuar në përfundimin e saj të hershëm ose për zbatimin e dëmeve të likuiduara ose dënimeve të tjera kontraktuale ose që ka qenë zbuluar në vijim kontrollë, ose hetime nga një zyrtar autorizues, OLAF ose Gjykata e Auditorëve;
- është vërtetuar me vendim të formës së prerë, ose me vendim të formës së prerë administrative që operatori ekonomik ka kryer një parregullsi brenda kuptimit të nenit 1 (2) të Këshillit Rregullorja (KE, Euratom) Nr. 2988/95124.
- Në rastet e përmendura në pikat (c), (d) dhe (f) në mungesë të aktgjykimit të formës së prerë ose vendimit përfundimtar administrativ, ose në rastin e përmendur në pikën (e), kur autoriteti kontraktues disponon fakte të themelimit apo gjetjeve të tjera, ajo përjashton një operator ekonomik në bazë të një klasifikimi paraprak të ligjit duke pasur parasysh rekomandimin e një paneli të pavarur për të siguruar një vlerësim të centralizuar të këtyre situatave.
- Në menaxhimin indirekt, sipas rastit së marrëveshjes së financimit ose të delegimit korrespondent, autoriteti kontraktues do të transmetojë informacionin për Komisionin, dhe Komisionin do t'i referohet çështjes panelit.
- Autoriteti kontraktues do të përjashtojë operatorin ekonomik kur një person i cili është anëtar i organit administrativ, menaxhues ose mbikëqyrës ose ka fuqi për përfaqësim, vendim ose kontroll mbi operatorin ekonomik është në një situatë të renditur në pikat (c), (d), (e) ose (f). Kjo vlen edhe për personin fizik ose juridik që merr përgjegjësi të pakufizuar për borxhet e atij operatori ekonomik është në një gjendje të shënuar në pikat (a) ose (b).
- Pika (a) nuk zbatohet për blerjen e furnizimeve me kushte veçanërisht të favorshme nga ose a furnizuesi i cili përfundon përfundimisht aktivitetet e tij të biznesit ose nga likuiduesit e një falimentimi, nëpërmjet një marrëveshje me kreditorët, ose nëpërmjet një procedure të ngjashme sipas ligjit kombëtar.

Autoriteti kontraktues nuk do të përjashtojë një operator ekonomik kur mund ta tregojë atë se a janë miratuar masa adekuate që sigurojnë besueshmërinë e saj, përveç rasteve të renditura në pikën (d), kur është e domosdoshme për vazhdimësinë e shërbimit për një kohëzgjatje të kufizuar dhe në pritje të miratimit të masave përmirësuese, ku përjashtimi do të ishte jo-proporcional.

TOKA nuk merr përgjegjësi për të kompensuar çfarëdo kosto të bërë nga ofertuesit kur përgatisin oferta.